



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 65 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/03 prill 2017, Prishtinë), dhe në zbatim të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9, nenit 8 dhe nenit 9, si dhe bazuar në nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 23 dhjetor 2025 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR LICENCIMIN E BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja, të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 30 prill 2020 (më tutje: rregullorja bazë).

Neni 2

1. Neni 6 të rregullores bazë, i shtohet paragrafi 6 me tekstin si në vijim:
 6. Nëse banka apo banka e propozuar nuk ka aksionar kryesor, dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me aksionarët kryesorë aplikohen për deri në 20 aksionarët më të mëdhenj të bankës apo bankës së propozuar.

Neni 3

Efektet dhe hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë rregullore, mbeten në fuqi.
2. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës